

VENDIM
Nr. 755, datë 1.12.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 308, DATË 21.5.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PAKETAVE TË SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE, QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË
DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË SHËRBIMIN SPITALOR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 6, të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 8, e vendimit nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Çmimet e paketave të shërbimeve shëndetësore rishikohen periodikisht, sipas vlerësimit të faktorëve socialë, ekonomikë dhe shëndetësorë nga një komision i kostifikimit të paketave shëndetësore, i cili përcaktohet nga Këshilli Administrativ i Fondit, me pjesëmarrës nga shërbimet shëndetësore publike, përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të Fondit. Ndryshimi i çmimeve bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
BELINDA BALLUKU